



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 42/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së tubimit publik para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale në komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 17.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më 13.04.2012, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, më të cilën pretendohet se LVV ka organizuar dhe mbajtur tubim publik me datën 10.04.2012, në ora 20:00, në shkollën fillore “Naim Frashëri” në fshatin Zaskok, sipas parashtruesit të ankesës është thyer Rregulla Zgjedhore nr. 13/2009 “*Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*”. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë ftesën e LVV për mbajtjen e tubimit publik.

Parashtruesi i ankesës propozon që të shqiptohen masa ndëshkimore ligjore ndaj subjektit politik në fjalë.

### **KREU -VII- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)**

#### **Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike**

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar.**

Për shkak se pretendimet nga parashtruesi i ankesës se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009 “Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike” nuk qëndrojnë ngase rregulla në fjalë ka të bëjë vetëm me tubimet publike të cilat mbahen brenda kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, meqenëse mbajtja e tubimit publik është bërë para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore siç pretendohet në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore konstatoi se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së e as me Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë marrja e masave ndëshkimore, për mbajtjen e tubimeve publike apo fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t’i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 42/2012 më datën 17.04.2012.

